

RRUZARJA E
SHENJTË



Çfarë është Rruzarja?

- Rruzarja (nga lat. Rosarium) është një lutje devocionale, kontemplative me karakter litanik e ritit latin të Kishës Katolike.
- Rruzarja merr emrin nga fjala “rosa” pra “trëndafil” dhe simbolizon trëndafilat erëkëndshëm që ato që lusin këtë lutje i dhurojnë Zojës Mari, nënës së Jezu Krishtit.
- Rruzarja është një nga lutjet më të fuqishme që na ka dhënë Kisha Katolike, e quajtur nga vetë Zoja si ilaçi kundër çdo të keqeje dhe nga shenjt i madh Padre Pio si “armë e fuqishme kundër të keqit”. Përbiles, shenjt i madh marian Shën Luigi Grignon de Monfort thoshte që “shpëtimi I botës ka filluar pikërisht përmes Të Falemi Marisë dhe shpëtimi i secilit prej nesh ka lidhje me këtë lutje”.



HISTORIA E RRUZARES

- Rruzarja është një lutje antike, e njohur nga anëtarë të Kishës Katolike që në vitet e para të Krishtërit, sidomos nga murgjërët e nga etërit e shkretërirës, që e përdorinin pikërisht si një armë kundër tundimeve djallëzore.
- Por, për të gjithë njerëzit e tjerë të thjeshtë, sidomos për laikët e Kishës Katolike, u bë e njohur vetëm falë përhapjes masive të bërë nga Shenjti Domenik i Guzmanit (1170-1221), shenjt spanjoll i cili i gjendur në Tolozë të Francës për të luftuar me lutjen dhe predikimin e tij herezitë e lindura ndër albigjezët e asaj zone, e shikonte që çdo gjë që ai provonte ishte një dështim i vërtetë dhe nuk arrinte t'i kthente dot në rrugën e drejtë. Atëhere, i dëshpëruar tërhiqet për lutje e për pendesë në një shpellë afër Tolozës, duke i kërkuar Zojës një lutje që të mund të mposhte çdo të keqe. Në ato çaste, i shfaqet vetë Zoja Mari e i dorëzon në këtë vizion Rruzaren e shenjtë, si një ilaç i vërtetë kundër çdo të keqeje, duke i dhënë misionin që të përhapë Rruzaren në të gjithë botën e t'i mësojë të gjithë që ta lusin.
- Kështu Rruzarja erdhi në ditët tona, falë veprës së Shën Domenikut e të fretërve të tjerë të urdhrit të themeluar nga vetë ai (Urdhri i predikuesve ose Domenikan), sidomos falë veprës të së Lumit Alano i Rupes (1428-1475), një prift domenikan shumë i lidhur me Rruzaren.



SI ËSHTË E PËRBËRË RRUZARJA?

Rruzarja tradicionalisht është e përbërë nga tre të ashtuquajtura “kurora” të cilat përmbajnë secila nga 50 Të falemi Mari, pra gjithsej e përbërë nga 150 Të falemi Mari, në analogji me 150 Psalmet e Davidit, arsye për të cilën Rruzarja quhej edhe “Psalteri i Jezusit dhe i Marisë”.

Në secilën kurorë janë të përmbajtura misteret e jetës së Jezu Krishtit duke filluar që nga lindja dhe fëmijëria e tij (misteret e gëzimit); vuajtja e vdekja e tij në kryq (misteret e dhimbjes) dhe ringjallja së bashku me ngjarjet pas ringjalljes së Jezusit (misteret e lavdisë). Shën Gjon Pali II, më 16 tetor 2002, ka shtuar edhe misteret e dritës (që përmbajnë ngjarjet kryesore të jetës publike të Jezu Krishtit), por këto mistere nuk janë të detyrueshme dhe nuk e prishin rendin e Rruzares tradicionale.

Secili Mister ndiqet nga një lutje e Ati ynë, që është lutja që u ka mësuar vetë Jezu Krishti nxënësve të tij (Luka 11, 1-4); nga lutja e Të falemi Mari e përsëritur 10 herë (lutja e të Falemi Mari është e përbërë në pjesën e parë nga fjalët e Kryengjellit Gabriel drejtuar Zojës Mari (Luka 1, 28) e nga fjalët e Shenjtes Elizabeta drejtuar Zojës Mari (Luka 1, 42), ndërsa pjesa e dytë është shkruar nga Kisha, për ta plotësuar këtë lutje) dhe nga 1 lutje e Lavdi Atit. Zakonisht Rruzarja përmbillet me Të falemi Mbretëresha (lutje mariane që është kompozuar në Mesjetë).

Rruzarja është një lutje jo vetëm vokale, por edhe soditëse (kontemplative) prandaj së bashku me shpalljen e mistereve dhe recitimin e lutjeve Ati Ynë e Të falemi Mari duhet të meditohe në zemrën e atij që i lut, misteret e sipërpërmendura. Këto mistere të jetës së Jezu Krishtit meditohe nëpërmjet këndvështrimit së nënës së tij Zojës Mari, prandaj mund të themi që Rruzarja është një lutje mariane, por është po ashtu “Cristocentrike”, pra që vë në qendër Jezu Krishtin.

SA SHPESH DUHET TA LUSIM RRUZAREN?

- Tradicionalisht, Rruzarja lutej e plotë, pra çdo ditë besimtarët lusnin misteret e gëzimit, të dhimbjes e të lavdisë, duke arritur kështu që të lusin gjithsej 150 Të Falemi Mari në ditë. Në ditët tona, për të ndihmuar besimtarët që nuk kanë mundësi të lusin rruzaren e plotë çdo ditë, Kisha ka caktuar për çdo ditë të javës misteret përkatëse, në mënyrë që të lutet të paktën një kurorë e Ruzares (e përbërë nga 50 Të Falemi Mari) çdo ditë.

- Konkretisht Kisha ka caktuar që:
- Të hënën e të shtunën të luten misteret e gëzimit të Rruzares
- Të martën e të premtën të luten misteret e dhimbjes të Rruzares
- Të mërkurën e të dielën të luten misteret e lavdisë të Rruzares
- Të enjten të luten misteret e dritës të Rruzares
- Megjithatë, duke ditur të mirat e shumta që marrim nga recitimi i rruzares, asgjë nuk na pengon, nëqse kemi dëshirë e mundësi, që të lusim përditë Rruzaren e plotë të përbërë nga 150 Të falemi Mari (pra misteret e gëzimit, të dhimbjes e të lavdisë) ose akoma edhe më shumë se kaq. Kjo gjë nuk duhet të na çudisë, pasi ka patur shenjtër si Padre Pio që kanë arritur të lusin edhe 100 Rruzare në ditë.

Misteret e gëzimit dhe ditët në të cilat thuhen

Të hënën dhe të shtunën thuhen misteret e gëzimit që janë:


- Misteri i parë: Lajmërimi i Kryengjellit Gabriel Zojës Mari
- Misteri i dytë: Vizita e Zojës tek shenjtja Elizabeta
- Misteri i tretë: Lindja e Jezusit në shpellën e Betlehemit
- Misteri i katërt: Prezantimi i Jezusit në tempull
- Misteri i pestë: Humbja e gjetja e Jezusit në tempull



Misteret e dritës dhe ditët në të cilat thuhen

Të enjten thuhen misteret e dritës që janë:


- Misteri i parë: Pagëzimi i Jezusit në Jordan
- Misteri i dytë: Jezusi bën mrekullinë e parë në darkën e Kanës
- Misteri i tretë: Jezusi thotë kthehuni e besojini ungjillit
- Misteri i katërt: Shndërrimi i Jezusit në malin Tabor
- Misteri i pestë: Themelimi i Eukaristisë



Misteret e dhimbjes dhe ditët në të cilat thuhen

Të martën dhe të premtën thuhen misteret e dhimbjes që janë:

- Misteri i parë: Agonia e Jezusit në kopshtin e ullinjve
- Misteri i dytë: Fshikullimi i Jezusit
- Misteri i tretë: Kurorëzimi i Jezusit me ferra
- Misteri i katërt: Ngjitja e Jezusit në malin e Kalvarit
- Misteri i pestë: Kryqëzimi e vdekja e Jezusit në kryq



Misteret e lavdisë dhe ditët në të cilat thuhen

Të mërkurën dhe të dielën thuhen misteret e lumturisë që janë:

- Misteri i parë: Ringjallja e Jezusit nga te vdekurit
- Misteri i dytë: Ngjitja e Jezusit në qiell
- Misteri i tretë: Zbritja e Shpirtit të Shenjtë mbi apostujt dhe Marinë
- Misteri i katërt: Ngjitja e Zojës në qiell me trup e me shpirt
- Misteri i pestë: Kurorëzimi i Zojës si mbretereshe e qiellit dhe e tokës



SI LUTET RRUZARJA

- Fillohet lutja duke bërë shenjën e Kryqit: Në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt. Amen.
- Pastaj shpallet misteri i parë i ditës që i përket asaj dite (le ta zëmë që është e shtunë, pra janë misteret e gëzimit) dmth thuhet kështu: Në misterin e parë të gëzimit të mendojmë lajmërimin e Kryengjellit Gabriel Zojës Mari që do të bëhej nëna e Zotit tonë Jezu Krishtit.
- Pastaj thuhen:

1 Ati ynë

Ati ynë, që je në qiell, u shenjtëroftë emri yt, ardhtë Mbretëria jote, u bëftë vullnesa jote, si në qiell, ashtu në tokë! Bukën tonë të përditshme na e jep sot; na i fal fajet tona, si i falim ne fajtorët tanë. E mos na lër të biem në tundim, por na liro nga i keqi. Amen!

10 Të falemi Mari

Të falëm Mari, hirplote, Zoti me ty! E bekuar je mbi të gjitha gratë dhe i bekuar fryti i barkut tënd, Jezusi.

Shenjtja Mari, Nëna e Hyjit, lutu për ne mëkatarët, tash e në fill të vdekjes sonë. Amen!

1 Lavdi Atit

Lavdi Atit, e Birit e Shpirtit Shenjt! Si ka qenë në fillim, ashtu tash e përgjithmonë e jetës. Amen!

SI LUTET RRUZARJA

- Shpallet misteri i dytë i gëzimit: Në misterin e dytë të gëzimit të mendojmë Vizitën e Zojës Mari Shenjtes Elizabeta e ndjekur sërish nga 1 Ati ynë, 10 Të falemi Mari, 1 Lavdi Atit
- Shpallet misteri i tretë i gëzimit: Në misterin e tretë të gëzimit të mendojmë Lindjen e Jezusit në shpellën e Betlehemit e ndjekur nga 1 Ati ynë, 10 Të Falemi Mari, 1 Lavdi Atit
- Shpallet misteri i katërt i gëzimit: Në misterin e katërt të gëzimit të mendojmë Prezantimit e Jezusit në tempull e ndjekur nga 1 Ati ynë, 10 Të falemi Mari, 1 Lavdi Atit
- Shpallet Misteri i pestë i gëzimit: Në misterin e pestë të gëzimit të mendojmë Humbjen e gjetjen e Jezusit në tempull e ndjekur nga 1 Ati ynë, 10 të Falemi Mari, 1 Lavdi Atit
- Rruzarja përfundon me lutjen përmbyllëse:

Të Falem Mbretëreshë

Të falem mbretëreshë, Nëna e mëshirës, jeta, ëmbëlsimi e shpresa jonë, të falemi! Ty të thërrasim ne të shkretët, bijtë e Evës, që po fshajmë, po gjëmojmë e po qajmë në këtë shekull plot me lot. Deh pra, pajtorja jonë, ata sy të mëshirshëm të tu silli prej nesh! E Jezusin, të bekuarin, frytin e barkut tënd, pas kësaj shkretie na e kallëzo. O e dhimbshmja, o e buta, o e ëmbla Virgjëra Mari! Amen!

- E njëjta gjë do të bëhet për ditën e tjera, vetëm se në vend të mistereve të gëzimit, do të thuhet misteret që i përkasin asaj dite.



SI PËRDORET KURORA E RRUZARES?

- Zakonisht Rruzarja lutet me anë të së ashtuquajturës “kurorë e Rruzares” që është një mjet që është krijuar për ta bërë më të lehtë recitimin e Rruzares dhe mbajtjen e rendit të lutjeve. Kurorat e Rruzares janë nga më të ndryshmet, por ajo më e përdorura është prej Kurora tipike prej 50 Të Falemi Mari, siç e shikojmë në foto. Konkretisht, kemi vendosur numrat në rruazat për lehtësi shpjegimi dhe mund të themi që:

1. Në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt. Amen.

2. Ati Ynë

3. Në tre rruazat respektivisht (fakultative):

- Për ndërmjetësimin e Zojës Mari të lutemi që Zoti të na rrisë fenë: Të Falemi Mari

- Për ndërmjetësimin e Zojës Mari të lutemi që Zoti të na rrisë shpresën: Të falemi Mari

- Për ndërmjetësimin e Zojës Mari të lutemi që Zoti të na rrisë dashurinë: Të falemi Mari Lavdi

4. Lavdi Atit

5. Shpallja e misterit të parë e ndjekur nga 1 Ati ynë

6. Në secilën rruazë (janë dhjetë rruaza gjithsej) thuhet nga 1 të Falemi Mari, pra janë 10 Të falemi Mari gjithsej

7. Lavdi Atit; Shpallja e misterit të dytë e ndjekur nga 1 Ati ynë





VËLLAZËRIA E RRUZARES SË SHENJTË

Cfarë është?

Vëllazëria e Ruzares së Shenjtë është një shoqatë ndërkombëtare e besimtarëve katolikë, e themeluar me qëllimin për të nderuar e lutur Zojën Mari nënën e Jezu Krishtit dhe për të patur mbrojtjen e saj të veçantë nëpërmjet recitimit të Ruzares, për të marrë të mira shpirtërore reciproke të shumta ndër besimtarët e mbarë botës që bëjnë pjesë në këtë Vëllazëri.



Si ka lindur?

- Vëllazëria e Rruzares së Shenjtë është themeluar nga Zoja Rruzare në vitin 1214 kur vetë Zoja i kërkoi Shën Domenikut (i cili përpara kishte marrë Rruzaren nga vetë duart e Zojës Rruzare në Tolosa të Francës), që të themelojë një Vëllazëri të Rruzares për mëkatarët që donin të bënin pjesë në këtë Vëllazëri.
- Për këtë arsye Shën Domeniku themeloi Vëllazërinë e parë të Rruzares për piratët që e kishin grabitur në anijen e tyre në natën midis 24 e 25 marsit (Zoja Nunciatë) të vitit 1214 kur anija po përpihej nga dallgët. Piratët u kthyen tek Krishti dhe u bënë pjesëmarrësit e parë në Vëllazërinë e Rruzares.
- Dy shekuj më vonë, në vitin 1464, Zoja ju shfaq në Douai të Lumit Alano i Rupes dhe ai themeloi një Vëllazëri të Rruzares në Kishën Notre Dame në Douai që u pranua nga Urdhri Domenikan në vitin 1470.
- Vëllazëritë e Rruzares bëjnë pjesë në familjen e madhe të Urdhrit Domenikan (të Shën Domenikut) një urdhër shumë i rëndësishëm i Kishës Katolike dhe që nga fundi i vitit 1800 Papa Leone XIII i hoqi Urdhrit Domenikan privilegjin e përkatësisë së Vëllazërisë së Rruzares duke e bërë të mundur që të ngrihen kudo.
- Kur bëjmë pjesë në këtë Vëllazëri bëjmë pjesë në familjen domenikane, por jo në urdhrin domenikan.



Cilat jane të mirat që marrim nga pjesëmarrja në këtë Vëllazëri?

- A. Bëhemi pjesëmarrës e të mirave të panumërta që vijnë nga të gjitha rruzaret e bëra nga pjesëtarët e shumtë të kësaj Vëllazërie në botë e ndër vite, duke filluar që nga viti 1214, viti i themelimit të Vëllazërisë së Rruzares.
- B. Bëhemi pjesëmarrës e të mirave të jashtëzakonshme që vijnë nga rruzaret e panumërta të bëra nga murgeshat, fretërit, priftërinjtë, laikët e Urdhrit Domenikan dhe mbi të gjitha e të mirave që vijnë nga rruzaret e shenjtërve të urdhrit domenikan (mjafton të përmendim Shën Domenikun, të Lumin Alano i Rupes, Shenjten Katerinë e Sienës, Shën Pio V, Shenjtjen Roza e Limës, Shën Tomën e Akuinit, Të Lumin Pier Giorgio Frassati, etj).
- C. Çdo javë në çdo manastir të Urdhrit Domenikan bëhet Meshja e Shenjtë Pro Defunctis (pra për të gjithë ato besimtarë të vdekur që bëjnë pjesë në këtë Vëllazëri); kjo meshë bëhet përgjithmonë, pra do të bëhet edhe pas vdekjes sonë për ata që janë të regjistruar në këtë Vëllazëri

Cilat jane të mirat që marrim nga pjesëmarrja në këtë Vëllazëri?

D. Sipas të lumit Alano i Rupes, pjesëmarrësit në këtë Vëllazëri kanë privilegjin e një mbrojtjeje të veçantë nga Jezusi e Maria dhe trajtohen nga ata në mënyrë të veçantë, si fëmijë të përzgjedhur, me premtimin e çdo mbrojtjeje në jetë, gjatë vdekjes dhe pas vdekjes. Zoja u ka dhënë 15 premtime atyre që lusin rruzaren (Rruzarianëve) dhe bëjnë pjesë në këtë Vëllazëri, që janë këto:

- 1) Mbrojtjen e veçantë të Zojës Mari dhe hire shumë të mëdha
- 2) Hire të veçanta për Rruzarianët (ata që lusin Rruzaren) që këmbëngulin në lutjen e Rruzares
- 3) Rruzarianët (ata që lusin Rruzaren) do të gjejnë në Rruzaren si një armë të fuqishme kundër ferrit, për të shkatërruar veset, për të liruar nga mëkatet, për të hequr herezitë
- 4) Rruzarianët do të lulëzojnë në virtyte dhe në vepra të mira dhe do t'u japin shpirtrave njerëzorë shumë mëshira hyjnore; ata do të zëvendësojnë në zemrat e tyre dashurinë ndaj botës me dashurinë ndaj Zotit: oh, sa shpirtra do të shenjtërohen nëpërmjet këtij mjeti!
- 5) Rruzarianët i janë besuar Zojës Rruzare dhe nuk do të humbasin në amshim
- 6) Rruzarianët devotë nuk do të ngelin pa hirin e Zotit: nqs janë mëkatarë do të kthehen tek Krishti; nqs janë të drejtë do të vazhdojnë të jetojnë në hir dhe do të bëhen të denjë për Jetën e Amshuar.
- 7) Rruzarianët devotë nuk do të vdesin pa marrë Sakramentet e Kishës.
- 8) Rruzarianët do të ndriçohen nga Zoti në jetë dhe në vdekje dhe do të marrin hire pa fund dhe në Qiell do të marrin pjesë në meritat e Shenjtërve.
- 9) Zoja e Rruzares do të lirojë në çast nga Purgatori shpirtrat e njerëzve të përkushtuar ndaj Rruzares.
- 10) Rruzarianët do të kenë një lavdi të madhe në Qiell.
- 11) Atë që Rruzarianët do të kërkojnë nëpërmjet Rruzares së Shenjtë, do ta marrin.
- 12) Atë që e përhap Rruzaren e Shenjtë, Zoja do ta ndihmojë në çdo lloj nevoje.
- 13) Rruzarianët e Vëllazërisë së Rruzares do të kenë si vëllezër të gjithë shenjtërit e Qiellit si në jetë ashtu edhe në orën e vdekjes së tyre.
- 14) Rruzarianët besnikë janë fëmijë fort të dashur nga Zoja Rruzare, vëllezër e motra të Jezu Krishtit.
- 15) Devocioni ndaj Rruzares së Shenjtë është një shenjë e vërtetë që shpirti është në rrugën e shpëtimit të amshuar.

Cilat jane të mirat që marrim nga pjesëmarrja në këtë Vëllazëri?

- E. Pjesëmarrësit kanë të drejtën e indulgjencave plenare të shumta (pra të shlyerjes së plotë të dënimit që vjen nga mëkatet e bëra dhe të falura nëpërmjet rrëfimit). Indulgjenca (falja) mund të ofrohet për veten ose për të vdekurit.

Indulgjenca plenare (falja e plotë) janë në këto ditë:

Në ditën kur regjistroheni në Vëllazëri; në festën e Krishtlindjes (25 dhjetor), në festën e Pashkëve, në festën e Zojës Nunciatë (25 mars), në festën e Ngjitjes së Zojës në Qiell (15 gusht), në festën e Zojës Rruzare (7 tetor), në festën e Zojës së Papërlyer (8 dhjetor), në festën e Prezantimit të Jezusit në Tempull (2 shkurt).

Po ashtu, jepet indulgjenca plenare për ata që thonë rruzaren në kishë, në Vëllazëri apo në familje.

Ato që lusin të tre kurorat e Rruzares në ditë (dmth misteret e gëzimit, të dhimbjes dhe të lavdisë) marrin, kudo që të gjenden, faljen e plotë.

Në rastet e tjera indulgjenca është vetëm e pjeshme (falja e pjeshme e dënimit që vjen nga mëkatet e bëra).

Kushtet për të fituar indulgjencën plenare janë: rrëfimi, kungimi, lutje sipas njetit të Atit të Shenjtë në atë ditë kur jepet indulgjenca. Po ashtu kërkohet shkëputja nga çdo lloj lidhjeje me mëkatin, qoftë edhe mëkatet e vogla.

Si fitohen gjithë këto të mira shpirtërore?

Këto të mira shpirtërore fitohen në momentin që regjistrohemi në këtë Vëllazëri të Rruzares dhe duke mbajtur këto premtime:

A. Në momentin që regjistrohemi themi në zemrën tonë që lutjet e rruzares do i bëjmë për njetet personale por edhe për ato të të gjithë pjesëmarrësve të tjerë të Vëllazërisë. Mjafton ta themi si një mendim brenda vetes në momentin që regjistrohemi dhe kaq, nuk ka nevojë ta përsërisim përherë.

B. Të lusim të paktën tre rruzare në javë (pra misteret e gëzimit, të dhimbjes e të lavdisë).

Tre Rruzaret mund të thuhën në ditë të ndryshme. Kush thotë më shumë se tre rruzare në javë (psh besimtarët që thonë rruzaren përditë) akoma edhe më mirë, marrin edhe më shumë të mira.

Këto premtime për një besimtar/e që lutet rregullisht janë me të vërtetë minimale dhe ja vlen të specifikoj që nqs nuk arrijmë t'i mbajmë për ndonjë motiv, **NUK KRYEJMË ASNJË MËKAT!** E vetmja gjë, që nuk marrim pjesë në të mirat që do të na vinin sikur t'i kishim thënë rruzaret atë javë, por e përsëris nuk kryejmë asnjë mëkat nqs regjistrohemi por për një periudhë kohe pak a shumë të shkurtër apo edhe për përherë, nuk arrijmë të mbajmë premtimet e sipërpërmendura. Këtë e përsëris sepse mund të ketë njerëz me skrupuj që kanë ndjenjën e fajit apo të përgjegjësisë së tepërt.





A duhet të paguaj për t'u regjistruar në këtë Vëllazëri?

Absolutisht jo! Në këtë Vëllazëri asnjë njeri nuk bën asnjë lloj pagese dhe nuk kërkohet asnjë qindarkë për asgjë; kjo Vëllazëri ka vetëm qëllimin e të mirave SHPIRTËRORE.

A mund t'i besoj kësaj Vëllazërie, a nuk është ndonjë sekt apo diçka tjetër e çuditshme?

- Jo, kjo Vëllazëri nuk është sekt dhe asgjë tjetër e çuditshme. Një sekt mund të njihet sepse ka tekste sekrete dhe bën mbledhje sekrete, kurse Vëllazëria e Ruzares i ka të gjitha tekstet e saj të publikuara në këtë sit: www.beatoalano.it/al dhe po ashtu mbledhjet janë gjithnjë publike.
- Ky është një website zyrtar i priftit Don Roberto Paola, prift i Kishës Katolike, i Famullisë së San Luca Evangelista në Romë.
- Mund të kërkoni informacione të mëtejshme dhe sqarime të tjera duke klikuar në rubrikat e tjerat të kësaj faqeje në shqip, në lidhje me Vëllazërinë e Ruzares ose duke i shkruar vetë priftit Don Roberto Paola, i cili merret personalisht me zhvillimin e kësaj Vëllazërie të Ruzares dhe të këtij website-i.



Kush mund të regjistrohet në Vëllazërinë e Rruzares së Shenjtë?

Kushdo mund të regjistrohet në Vëllazërinë e Rruzares së Shenjtë, pasi ka kuptuar dhe pranuar premtimet që bëjnë anëtarët e kësaj Vëllazërie të Rruzares, edhe pse mund të jetë mëkatar apo i çrregullt në lidhje me Kishën.

Si mund të regjistrohem në këtë Vëllazëri?

REGINA SACRATISSIMI ROSARII
BEATUS ALANUS DE RUPE
CONFRATERNITA SS. ROSARII



Sito Cattolico

Il sito del SS. Rosario e del suo eccelso cantore
il beato Alano delle Rupe (B. Alain de la Roche)

CHANGE LANGUAGE

- Home
- Kush Jemi
- Figura
- Video
- Vëllazëria
- Imusical
- Link
- Veprat e të Lumit Alano
- Përkthimet e veprave të të lumit Alano



Regjistrohu në Vëllazërinë e Rruzares së Shenjtë

Emër *

Mosha

M F

Qyteti *

* Fusha me detyrim për t'u plotësuar

- Mund të regjistroheni personalisht në këtë faqe interneti: www.beatoalano.it/al
- Klikoni tek link-u; shkoni tek “Vëllazëria”, pastaj tek “Si të regjistrohem”; klikoni “Vazhdo”
- Vendosni emrin tuaj dhe qytetin e prejardhjes e pastaj klikoni “Dërgo” (faqja që shihni në sfond)
- Mund të kontrolloni regjistrimin tuaj tek “Libri I Vëllazërisë së Rruzares së Shenjtë”
- Kjo listë është e lidhur shpirtërisht me Vëllazërinë e Rruzares së Shenjtë në Famullinë e Shën Luka Ungjilltar në Romë.

A është e nevojshme pjesëmarrja fizike për ata që regjistrohen online?

Pjesëmarrja fizike në Vëllazërinë e Rruzares (që ndodhet në Romë në famullinë e Shën Luka Ungjilltar) nuk është e detyrueshme dhe as e nevojshme as në momentin e regjistrimit e as pastaj.

Por do të ishte bukur sikur secili, pas e ka zbuluar dhuratën e veçantë të Vëllazërisë së Rruzares, të mund të përhapë një Vëllazëri që ta binjakëzojë me Vëllazërinë tonë në Romë, o në shtëpinë e vet ose në famullinë përkatëse, ose në Institutin fetar përkatës.

Regjistri online e pasuron shumë Vëllazërinë e Rruzares në Famullinë Shën Luka Ungjilltar në Romë nëpërmjet Rruzarianëve që lusin rruzaren aty ku ndodhen, në çdo vend të botës që ndodhen, duke marrë pjesë shpirtërisht në Vëllazëri.

Si mund të marr pjesë në lutjen e Vëllazërisë së Rruzares që transmetohet live?

- Vëllazëria e Rruzares së Shenjtë transmeton lutjen live nga Famullia e Shën Lukës Ungjilltar në Romë ku mbledhet çdo të dielë nga ora 16.30 deri në 18.30, në faqen e Facebook-ut të Vëllazërisë: CONFRATERNITA DEL SANTISSIMO ROSARIO, PARROCCHIA SAN LUCA EVANGELISTA, ROMA.
- Në këtë faqe Facebook-u mund të ndiqni lutjen e Rruzares së plotë ndërkohë që adhurohet i Shenjtërueshmi Sakrament dhe më pas do të ketë një katekezë të shkurtër të Don Roberto Paolas. Lutjen mund ta ndiqni live në oraret e përmendura më sipër ose e gjeni të regjistruar për ta ndjekur kur të keni mundësi.

Për më tepër konsultoni:

WWW.BEATOALANO.IT/AL

Gjeni gjithçka mbi Rruzaren e shenjtë, mbi Vëllazërinë e Rruzares, mbi të Lumin Alano i Rupes dhe librat e tij të perkthyer në shqip që mund të shkarkohen falas për lexim personal



FALEMINDERIT!